

E drejta për shprehje të lirë në normën e Kosovës

*Dr. Ibrahim Berisha**

Abstrakt

Punimi përqendrohet të analizojë normën rregulluese të medias në periudhën e tranzicionit medial, në një kontekst të specifikuar të marrëdhënieve publike, si dhe efektin etik dhe profesional të kësaj norme që ka të bëjë me të drejtën dhe lirinë për t'u shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacion. Qasja do të fokusohet në raportin publik të medias, pastaj audiencë, detyrim etik dhe e drejta ligjore në shoqërinë e Kosovës mbas vitit 1999. Analizohet norma rregulluese e ndarë në dy periudha: e para, periudha e mbas luftës, 1999-2006, kur shoqëria e Kosovës administrohet nga UNMIK (Korniza Kushtetuese, rregulloret për medie dhe vendimet administrative) dhe e dyta, periudha para dhe pas njohjes së shtetit të Kosovës nga bashkësia ndërkombëtare, 2006-2014, kur norma miratohet nga legjislativi i Republikës së Kosovës.

Fjalët kyçe: *Medie elektronike, e drejta, normë rregulluese, liri e shprehjes, Kosovë*

Deri në vitin 1989, kur nis rënja e sistemit komunist në Kosovë, sikur dhe në ish-Jugosllavi, kishim të bënim vetëm me mediet shtetërore. Ushtrohej kontroll i drejtpërdrejtë ideologjik-politik në emërimin e kuadrit udhëheqës, pastaj në caktimin e politikës redaktuese dhe të numrit të medieve elektronike dhe të shtypura. Në Kosovës rrjeti i Radiotelevizionit të Prishtinës¹ dhe të radiove lokale, pastaj gazetatat e përditshme "Rilindja",² revistat informative dhe kulturore, gazetatat në

* Prof. Asoc. Dr. Ibrahim Berisha, Universiteti i Prishtinës, Kolegji AAB.

¹ Në Kosovë Televizioni i Prishtinës emeton program nga nëntori i vitit 1975, në fillim me tri orë program në ditë.

² Gazetaria institucionale nis me gazetën *Rilindja*. Më 12 shkurt 1945 botohet numri i parë i fletushkës *Rilindja* në katër faqe me tirazh 1000 kopje.

gjuhën serbe e turke paraqesin sistemin informuese të opinionit publik. Informimi zhvillohet në tri gjuhë: shqip, RTP dhe gazeta "Rilindja", serbokroatisht RTP dhe gazeta Jedinstvo dhe turqisht RTP dhe gazeta Tan. Informimi elektronik formalisht ndërtohej bazuar në ligjet për informim dhe shfrytëzimin e rrjetit difuziv, miratuar nga Kuvendi i Kosovës, si organ më i lartë ligjdhënës i Krahinës Autonome. Ishin dy ligje të veçanta për rregullimin, organizimin dhe drejtimin e veprimtarisë së RTP-së: "Ligji mbi mjetet e informimit publik" dhe "Ligji mbi RTP-në". Sipas këtyre ligjeve, mbasi Kuvendi qe themelues, ai emëronte dhe drejtorin e përgjithshëm të RTP-së, drejtorin dhe kryeredaktorin e Radio-Prishtinës me një mandat 4-vjeçar. Formalisht duhej të kërkohej edhe mendimi i punonjësve të këtyre institucioneve përmes këshillave të punëtorëve.

Kuvendi i Kosovës shqyrtonte dhe miratonte planet pesëvjeçare. Si një bord publik, Kuvendi emëronte Pleqësinë Programore, organ ky që duhej të siguronte "mbrojtjen e interesit të veçantë shoqëror". Dy të tretat e Pleqësisë ishin përfaqësues të institucioneve dhe të organizatave të ndryshme shoqërore, politike dhe profesionale, kurse një e treta paraqiste grupin e punonjësve të medias përkatëse. Kjo vlente për të gjitha mediet elektronike, qofshin qendrore qofshin lokale.

Radio Televizioni i Prishtinës, njëherësh paraqet edhe institucionin radiodifuziv të Kosovës,³ nga i cili sigurohej rrjeti konvencional emetues për tërë Kosovën. Ky institucion dispononte me frekuencat radiotelevizive për mediet elektronike në Kosovë. Themelues i RTP-së ishte Kuvendi i Kosovës, kishte një pavarësi të kufizuar juridike në sferën e informimit nga ish-federatën jugosllave, por politikisht ishte i varur nga direktivat ideologjike të LKJ, jo vetëm në përmbajtjet informative, por edhe ato kulturore dhe dokumentare. Kuvendi i

Rilindja fillon punën me një redaktor dhe tre gazetarë. Nga viti 1948 deri më 1957 kjo gazetë e vetme në gjuhën shqipe botohet dy herë në javë, ndërsa nga nëntori i vitit 1958 del si e përditshme.

³ Themeluar në vitin 2005, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është organ kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit në Republikën e Kosovës. Me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës KPM përcaktohet organ i pavarur.

Kosovës mbikëqyr dhe ishte përgjegjës për zhvillimin e medieve elektronike, për ndryshim nga mediet e shkruara, ku këtë përgjegjësi e kishte LSPPK (Lidhja Socialiste e Popullit Punues të Kosovës), një organizim i ngjashëm me frontin popullor në shtetet e tjera socialiste. Sa do që nuk del në plan të parë autoriteti i Lidhjes Komuniste, strukturat e saj kontrollojnë dhe orientojnë tërësisht politikatat mediale. Në shtatë qendrat rajonale të Kosovës, kishte media lokale elektronike, radio të komunave, që themeloheshin dhe financoheshin nga kuvendet komunale.

Gazeta "Rilindja" paraqiste të vetmen ditore në gjuhën shqipe në Kosovë që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore. Themelues i saj ishte LSPK,⁴ kishte Pleqësinë që caktohej nga organizata që konsiderohej si themeluese e saj dhe format e kontrollit realizohen njësoj sikur edhe në rastin e RTP, përmes vendosjes së udhëheqjeve ekzekutive me pëlqime paraprake politike. Për të realizuar qeverisjen e brendshme në medie, ishin edhe Këshillat e Punëtorëve. RTP asnjëherë nuk qe në gjendje të sigurojë vetë mbulimin e shpenzimeve financiare. Nga reklamat dhe programet propaganduese siguroheshin 25-35 për qind të mjeteve, ndërsa 65-75 për qind siguroheshin nga Kuvendi, përkatësisht nga buxheti i Kosovës.

Sistemi medial i Kosovës që ishte ndërtuar gjatë viteve 1970-1980-të, radiotelevizioni qendror dhe radiot lokale, shtypi ditor "Rilindja" dhe revistat, u ndaluan në fillim të viteve '90, pas instalimit të apartheidit dhe krimit shtetëror serb në Kosovë nga regjimi i Beogradit. Televizionet dhe radiot nuk kishin mundësi teknike të vazhdonin punën e tyre, të cilat, veçmas radioja, kishte një traditë të nisur që në vitet '40-të, në kohën e Luftës së Dytë Botërore. Nga fundi i vitit 1941 nis emetimi i programit radiodifuziv edhe nga Prizreni. *Radio Prizreni* kishte fuqi transmetuese prej 200 vat. Programi kryesisht transmetohej në gjuhën shqipe dhe herë mbas herë edhe në atë turke. Nxënësit e gjimnazit real *Sami Frashëri* në Prishtinë zgjeruan rrjetin radiodifuziv në vitin 1942 me *Radio Kosova*, që kishte kapacitet transmetues prej 500 vat. Gazeta me një traditë 50-vjeçare "Rilindja" vazhdoi të dilte me

⁴ Lidhja Socialiste e Popullit Punues ishte organizata "më masive shoqërore-politike" në ish-Jugosllavi deri në vitin 1990.

emrin "Bujku"⁵ edhe pas vitit 1990, por pa të drejtën që të ketë rrjetin e vet të shpërndarjes, pastaj të shtypshkronjës me dy sisteme roto dhe *sistem ofset* nga më modernet në aspektin tekniko-teknologjik për kohën, ndërsa në lokalitë e vet, për të cilin kishte ndarë mjete të ndërtohej, u detyrua të paguante qira. Shantazhet për të ndaluar botimin e gazetës ishin të përhershme përmes presionit financiar, pasi nuk lejohej hapja e xhirollogarisë dhe marrja e fitimit nga shitja e gazetave. Ndërkohë, në Prishtinë nisi të dalë edhe një gazetë ditore, si vazhdimësi e revistës "Koha"⁶ me statusin e gazetës private, por e ndihmuar nga fundacione ndërkombëtare. Këtyre dy gazetave iu bashkëngjiti edhe "Kosova sot",⁷ e cila pjesërisht u financua po kështu nga donacionet ndërkombëtare. Statusi i gazetës "Bujku" ishte i pa definuar, pasi ajo nuk ishte regjistruar dhe nuk kishte titullar privat, kështu gazetarët dhe punonjësit e saj kishin krijuar statutin me cilësinë e aksionarëve të të gjithë punonjësve. Në Zvicër, nga viti 1992 nisi të dalë gazeta "Rilindja" që ishte gazeta "Bujku" e Prishtinës.

Pas vitit 1999 "Rilindja" nuk arriti të definojë pronarin, ndërkohë që edhe u mbyll përfundimisht pas marrjes së Pallatit të Shtypit për nevoja të UNMIK-t, ndërsa Radiotelevizionit të Prishtinës nuk iu lejua të punojë fare dhe as punonjësit e tij të kthehen në vendet e tyre të punës.

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, dr. Bernar Kushner, me një vendim të veçantë, i hapi rrugë fillimit të punës së një radiotelevizioni, i cili pastaj me vendimin nr.2001/13, të nënshkruar nga Hans Hakerup, pasardhës i Kushnerit në postin e Përfaqësuesit Special, themeloi Radio Televizionin e Kosovës si

⁵ Pas ndalimit të Gazetës Rilindja nga regjimi i Beogradit, më 1990, nisi të dalë gazeta ditore me emrin Bujku. Bujku ishte emri i revistës për Bujëqsi dhe Fshat që botohej në Prishtinë.

⁶ Numri i parë i gazetës *Koha ditore* doli më 3 prill 1997 dhe ajo botohej çdo ditë, pos të dielave. Nga 10 marsi i vitit 1998, gazeta botohej çdo ditë. Gazeta me pronar privat, *Koha Ditore*, u parapri nga revista *Koha* që dilte fillimisht çdo dy javë e më vonë çdo javë dhe me këtë dinamikë u botua, duke filluar nga shtatori 1990 deri në mars 1991.

⁷Gazeta *Kosova sot*, me botues privat, nisi të botohet në Prishtinë nga 12 shtatori 1998.

Shërbim i Transmetimeve Publike të Kosovës. Radio Televizioni i Kosovës nuk është vazhdim i institucionit të mëhershëm elektronik. Është krijuar nga Përfaqësuesi Special, përkatësisht UNMIKU, dhe në mënyrë të tërthortë, menaxhohet dhe kontrollohet nga strukturat referenciale të UNMIKU-t, të OSBE-së. Institucioni publik i RTK-së është i udhëhequr nga dy borde.⁸

Sipas një Raporti të TMC⁹ mund të përcaktohen disa nga elementet kryesore të zhvillimit të medieve elektronike e të shtypit në Kosovë. Në fund të vitit 2001, në Kosovë ishin të paraqitura për punë 48 radio në gjuhën shqipe, 22 radio në gjuhën serbe, nga 2 radio në gjuhën turke dhe boshnjake dhe tri radio në gjuhën rome. Përpos radiove të licencuara për të transmetuar emisione në një gjuhë, në Kosovë, veçmas nëpër komuna të përziera ku krahas shqiptarëve jetojnë edhe minoritetet, punojnë radiot në dy e tri gjuhë: 2 radio në gjuhë shqipe dhe serbe, 2 radio në gjuhë shqipe, serbe dhe turke, 2 radio në gjuhë shqipe dhe boshnjake, 1 radio në gjuhë shqipe, serbe dhe rome, 1 radio në gjuhë shqipe dhe gorane, 1 radio në gjuhë shqipe dhe turke, 2 radio në gjuhë serbe dhe rome. Raportit: Raport i TMC, Prishtinë 2002, në fund të vitit 2001, në Kosovë ishin për të emetuar program 15 televizione në gjuhën shqipe, 6 në gjuhën serbe, 1 në gjuhën shqipe, serbe dhe turke dhe 1 në gjuhën shqipe-boshnjake dhe turke.¹⁰

Numri kaq i madh i medieve elektronike mund të arsyetohet me donacionet që janë dhënë, veçmas për media të caktuara, radio dhe televizione, nga fondacione të huaja. Financimi është bërë për mediet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën e minoriteteve. Një pjesë e medieve financohet edhe nga biznesmenë privatë. Në gjuhën serbe financimi i disa medieve bëhet drejtpërdrejt, sikur edhe veprimtari të caktuara në enklava: shëndetësi, arsim, siguri etj., nga qeveria e Serbisë dhe organizatat nacionaliste serbe.

Shtypi që në pozitë ende më të pavolitshme, pasi shpenzimet për prodhimin e gazetave qenë mjaft të larta. Taksa në importin e letrës si

⁸ Sipas Rregullores 2001/13, RTK përbëhet nga Bordi i Drejtorëve dhe Bordi i Transmetuesve" (Nenit 2).

⁹ Doc, The Kosovo temporary media commissioner, report 2000-2001, Prishtinë, 2002.

¹⁰ Po aty.

dhe rritja e shpenzimeve të shtypit dhe të shpërndarjes, kanë ndikuar në uljen e tirazhit të gazetave për shkak të ngritjes së çmimit të tyre, që botuesit janë detyruar të bëjnë për të mos punuar me humbje. Gazetat pjesërisht janë financuar nga fondacione ndërkombëtare, por jo në mënyrë transparente dhe të barabartë. Kritikat e disa botuesve ndaj fondacioneve financuese të gazetave të caktuara, mbështetet në favorizimet e krijuara me pretekstin për të krijuar monopole në shtypin shqip të Kosovës. Nuk është e balancuar as përqindja e reklamave të dërguara nga UNMIK-u dhe fondacionet e tjera për shtypin. Gazetat ditore që botohen në gjuhën shqipe në Prishtinë, në fillim të vitit 2002, ishin: “Bota sot”, “Koha ditore”, “Zëri ditor”, “Epoka e re”, “Kosova sot” dhe “24 orë” (në vitin 2003 nuk botohet). Edhe “Rilindja” dhe “Gazeta e Re”, pushuan së dali për arsye financiare.

TMC-ja ka vendosur një rregull jopublik, i cili në parim vjen ndesh me vetë funksionin e medieve të lira. Gjobat, paratë e tubuara nga mediet e ndëshkuara kishte përkufizuar t’i përdorë për t’ua dhënë medieve të tjera. Për të inkurajuar gazetarinë “e mirë”, një term shumë relativ, TMC-ja vendosi të përdorë gjobat pa ndonjë procedurë transparente për t’ua dhënë medieve të caktuara. “Paratë e mbledhura nga redaktorët “e këqij” t’u jepen atyre “të mirëve” duke u dërguar kështu një sinjal profesionistëve, se në mënyrë që të bëjnë punën e tyre mirë është mirë, është e rëndësishme të çlirohen nga presionet politike dhe redaksionale”.

Administrata e UNMIKU-t pas vitit 1999 nxori rregullore, me të cilat përcaktonte detyrimet e medieve dhe një kod rigoroz të sjelljes së medieve dhe gazetarëve në Kosovë. Përfaqësuesi Special i sekretarit të OKB-së në Kosovë, Bernard Kushner, nënshkroi Rregulloren nr. 2000/37, me të cilën bëhet licencimi dhe rregullimi i medieve në Kosovë. Krahas Rregullorës për licencimin dhe rregullimin e medieve në Kosovë, Bernard Kushner, nënshkroi edhe Rregulloren për Shtypin e Shkruar 2000/36. Lidhur me këto rregullore ka pasur një varg reagimesh, veçmas nga përfaqësuesit e vetë medieve, të cilat e kanë cilësuar këtë dokument si shumë kufizues dhe censurës. Kompetencat e Përfaqësuesit Special kanë bërë që ai të krijojë këtë rregullore drastike. Neni 1\1 i kësaj Rregulloreje përcaktonte fuqinë e Komisarit

të Përkohshëm të Medieve, administrator ky i plotfuqishëm ndërkombëtar: "Komisari i Përkohshëm për Media është përgjegjës për zhvillimin dhe avancimin e medieve të pavarura profesionale dhe zbatimin e një sistemi të përkohshëm për të gjitha mediet në Kosovë derisa të themelohet një Komision i Përkohshëm i Medieve, që është i pavarur në kryerjen e këtyre detyrave". Në nenin 1\2, theksohet forcohet roli i Komisarit, mbasi "Komisarin e Përkohshëm për Media e emëron Përfaqësuesi Special i sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë".¹¹ Pra, vetë procedura e vendosjes së përgjegjësve për media në Kosovë, nuk kishte të bëjë me respektimin e procedurave demokratike. Më së paku që do të mund të thuhet, ishte fakti, se mënyra e vendosjes dhe e mjeteve që dispononte Komisari Special, që autoritare dhe kërcënuese.

Natyrisht për të forcuar pozitën e ndërkombëtarëve, po më këtë Rregullore ishin paraparë edhe dënimet drastike për të gjitha mediet, të cilat mund të vinin në kundërshtim me nenet e saj. Në Nenin 3 theksohej se kundër atyre që nuk i përmbahen kodit për transmetim mund të merren disa masa, ndër të cilat do veçuar atë më drastiken: Gjokitja deri në 100 mijë marka gjermane; Ndalimi i lejes së punës për transmetim; Marrja e pajisjeve; Ndërprerja e transmetimit.¹² Sipas neni 3\1: "Komisari i Përkohshëm për Media mund të kërkojë ndihmë nga autoritetet zyrtare përkatëse ligjore të Kosovës dhe nga zyrtarët përkatës publikë për zbatimin e një mase ndëshkuese".

Problem më vete paraqiste edhe neni 5\1, në të cilën provohej të rregullohet një fushë mjaft e gjerë dhe e paqartë: "Udhëheqësit e radios dhe televizionit do të përmbahen nga emetimi i detajeve personale për ndonjë individ, duke përfshirë emrin e tij, adresën apo vendin e punës në rastet kur një emetim i detajeve të tilla mund të paraqesë rrezik për jetën e atij individ, sigurinë e cilitdo individ, nga personat që marrin ligjin në duart e veta". Me këto nene hapur reduktohet mundësia e gazetarit për të shkruar të vërteta, në mënyrë që të ruhet paqja publike. Po kështu edhe rregullorja për shtypin koncentronte shumë kompetenca te komisarit për media. Në nenin

¹¹ Rregulloren nr. 2000/37, UNMIK, Prishtinë, Neni 1/2.

¹² Po aty

2\1, përcaktohen kompetencat ndëshkuese të tij: Të gjobisë deri në 100.000 marka gjermane ata që shkelin kodin apo rregullat e sjelljes; Mund t'u konfiskojë pajisjet dhe materialin dhe në fund mund edhe t'u ndalojë punën. Edhe në rregulloren për shtypin vlenin ndëshkimet e njëjta sikur për mediet elektronike. Me këtë Rregullore "ndalohet botimi i detajeve të individëve, të cilëve mendohet se u rrezikohet jeta, ngjashëm sikur në mediet elektronike". Nxjerrja restriktive e rregulloreve për mediet është paraprirë edhe në Kornizën Kushtetuese, në Kreun 8 (Kompetencat dhe përgjegjësitë e rezervuara për PSSP, pjesa (Y), ku saktësohej, mënyra e emërimeve të bordeve formalisht duke ruajtur shumicën nga Kosova, por praktikisht vendimet merreshin ndikuar nga anëtarët ndërkombëtarë. Po citojmë nene të Rregullores: "Emërimin e ekspertëve ndërkombëtarë në bordet administrative ose në komisionet e transmetuesve publikë, organin e pavarur për rregullimin e medieve dhe institucionet e tjera që merren me rregullimin e medieve publike me kusht që numri i kandidatëve të tilla nga PSSP-ja të mos e përbëjë shumicën e asnjë bordi administrativ". Procedurat dhe mënyra e emërimit të bordeve dhe të përfaqësuesve vendorë në këto borde gjatë tre vjetëve ka qenë e paqartë dhe jo transparente, dhe praktikisht, shumë herë ka pasur reagime nga gazetarët dhe asociacionet e tyre për anëtarët e emëruar, se një pjesë nuk janë marrë kurrë me gazetarinë dhe as me mediet.

Rregulloret e miratuara nga institucionet ndërkombëtare në Kosovë sakrifikan lirinë e medias, veçmas të vërtetën për llogari të paqes, e cila ishte prioritet i administrimit ndërkombëtar po edhe shihet si prioritet i perspektivës e popullsisë së Kosovës. Rregulloret sa kufizuan gazetarinë hulumtuese krahas shtrirjes së censurës, ndikuan edhe në rritjen e autcensurës ndër gazetarët duke bërë që të shtohet edhe presioni nga pronarët¹³ e medieve për të qenë shumë të kujdesshëm në temat që trajtojnë. Në Kosovë 14 për qind e gazetarëve janë skeptikë për zbatimin e garancive ligjore nga shkak i ndërhyrjes së pronarëve të medias.

¹³ Treguesit e medieve 2015, (2015), Prishtinë, f.10.

Pas shpalljes së Pavarësisë Kuvendi i Kosovës miratoi Kushtetutën e Kosovës.¹⁴ Në këtë dokument këto të drejta vihen në grupin e të drejtave dhe lirisë themelore të njeriut të klasifikuara si të drejta për liritë civile dhe politike, përcaktuar si liri e shprehjes, e të drejtës për qasje në dokumente publike dhe liri e medias. Krahas këtyre të drejtave është klasifikuar edhe liria e shprehjes me elementët kushtetues të saj dhe të garantuara, përfshirë: liria e të folurit, e paraqitjes publike dhe informimit publik; e drejta e themelimit të lirë të institucioneve për informim publik, në mënyrë të parashikuar me ligj; qasja e lirë ndaj informatave, liria e pranimit dhe bartjes së informatave; e drejta e përgjegjës në mjetet e informimit publik; e drejta e përmirësimit në mjetet e informimit publik; e drejta e mbrojtjes së burimit të informatës në mjetet e informimit publik; Censura është e ndaluar.

Nga parimet e kushtetutës kanë derivuar edhe ligjet që në mënyrë të drejtpërdrejtë janë të lidhura me lirinë e shprehjes dhe medien. Fusha e lirisë së shprehjes dhe e funksionimit të medias në Kosovës është e mbështetur me ligjet, të cilat janë të harmonizuara me parimet juridiko-politike dhe profesionale të Bashkimit Evropian. Por, bazuar në hulumtimet e shumta bërë në Kosovë në këto vite të fundit, zbatimi i ligjeve edhe në fushën e medias është fare i vogël duke sjellë në pozitë të vështirë gazetarët dhe gazetarinë profesionale. E dhëna se vetëm 52 për qind e gazetarëve besojnë se Kushtetuta e Kosovës garanton lirinë e shprehjes,¹⁵ tregon për pasigurinë e tyre në punën profesionale dhe të lirë e të mbrojtur plotësisht të hulumtojnë dhe të publikojnë të vërtetat që i interesojnë publikut.

Përfundime

Media, norma rregulluese dhe liria e shprehjes, e kushtëzuar nga sistemet politike në Kosovë, kaluan nëpër katër periudha: regjimi komunist (1945-1990), segregacioni dhe ndalesa e regjimit të

¹⁴ Doc. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, (2008), Prishtinë.

¹⁵ Treguesit e medieve 2015, (2015), Prishinë, f.10

Milosheviqit (1990-1999), Administrimi Ndërkombëtar (UNMIK) (1999-2008) dhe Pavarësia e Kosovës (2008-2014). Në periudhën komuniste nuk bëhet fjalë për liri të shprehjes, sepse prekja në “vlerat e socializmit vetëqeverisës” ishte e sanksionuar në mënyrë drastike. Është periudhë e kontrollit të plotë në politikat mediale dhe emërimet e udhëheqësve kryesorë si dhe kushtëzimi për perspektivën profesionale me “përshtatshmërinë ideo-politike”.

Periudha e segregacionit pas viteve 1990 është e njohur për ndalimin punës së medieve në gjuhën shqipe. Pas vitit 1999, Administrata Civile Ndërkombëtare e OKB (UNMIK), në mediet që u shumuan pa përfillur shumë kriteret profesionale dhe etike, vuri kontrollin përmes rregulloreve për medie elektronike dhe të shtypit, duke mos lënë hapësirë të duhur për gazetari profesionale dhe liri të plotë të shprehjes. E vërteta, si synim kryesor i lirisë së shprehjes, u sakrifikua për paqen e shoqërisë post-konfliktuale. Krahas censurës që kushtëzohet nga norma rregulluese, është e theksuar edhe autocensura nga gazetarët, që shtohet nga presioni i pronarëve që nuk duan t’i humbin donacionet ndërkombëtare me destinimin “për përkrahje të demokracisë dhe medias”.

Mbas vitit 2008, Kushtetua e Kosovës dhe gjithë ligjet që rregullojnë fushën e komunikimit publik, u miratuan duke qenë në parime dhe vlera korresponduese me parimet dhe vlerat demokratike të Bashkimit Evropian. Tani edhe pse ka një normë rregulluese funksionale, moszbatimi i saj, kërcënimi i gazetarëve dhe mbyllja e burimeve të informimit, ndikimi dhe influenza e politikës dhe pronarëve, reflektohet në lirinë e shprehjes dhe arritjen e standardeve profesionale dhe etike që e kërkon fusha e komunikimeve publike në një shoqëri demokratike.

Literatura

Berisha, Ibrahim, Media dhe tranzicioni (2006) Prishtinë
Monografia Kosova, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë

- Kosova Sot, Monografi, 1984, Prishtinë
- Sutaj, Ali, Rilindja 1945-1985, (1985), Monografi, Prishtinë
- Kushtetua e Republikës së Kosovës, (2013), Prishtinë, (me amendamentet I-XXIII)
- Ligji i Komisionit të Pavarur të Medies Nr. 04/L-44
- Ligji për Qasje në Dokumente Publike LIGJI Nr. 03/L-215
- Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë Ligji Nr. 04/L-137
- Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimet Kibernetik, Nr. 03/L-166
- Ligjin për Përgjimin e Telekomunikimeve, (2015) Prishtinë
- Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, NR. 02/L-65
- Ligji për Mbrojtjen e Informator Nr. 04/L-043
- Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës, Nr. 04/L-046
- Rregullore për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale
(KPM) nr. 04/L-44, KPM 2012/01
- Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, Nr. 04/L-065
- Rregulloren nr. 2000/37, UNMIK, Prishtinë,
- Rregulloren nr. 2000/36, UNMIK, Prishtinë